

RESPECTING STUDENTS' RIGHTS IN PRIMARY AND LOWER SECONDARY SCHOOLS

Avdyl Kastrati

Prishtina, Republic of Kosovo, avdylkastrati@hotmail.com

Abstract: Students' rights in schools are not to be discussed, they must be respected strictly. Social developments led to changes in society and education. Not long ago, children had no rights at all, but in time children began to be seen as human beings with their rights and obligations. Thus, over time, by using scientific knowledge and findings, it was seen that children are a sensitive category and they should be taken care of. Students in schools are at times treated unfairly, by teachers, school staff and their classmates as well. Teachers are the ones to be held responsible for any violation of students' rights in the classroom and school. Under no circumstances students should be ridiculed, beaten, insulted or let their rights be violated. Students' rights are guaranteed by international legal documents, and respecting students' rights also means respecting our future.

Through empirical research, the purpose of this study is to find out how much are students' rights respected in primary and lower secondary schools.

Empirical findings show that 86% of students and 89.4% of teachers consider that students' rights in school are respected, while 6.6% of students and 1.2% of teachers consider that the students' rights are not respected. Empirical results showed that there are statistically significant differences in the perception of teachers and students in terms of respecting students' rights in schools, since $Z = -5.431$, and $p = 0.000 < 0.05$.

Keywords: Rights, primary and lower secondary school, students, respect, schools

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NXËNËSVE NË SHKOLLËN NËNTËVJEÇARE

Avdyl Kastrati

Prishtinë, Republika e Kosovës, avdylkastrati@hotmail.com

Abstrakt: Të drejtat e nxënësve në shkollë nuk janë për t'u diskutuar, por duhet të respektohen me përpikëri. Zhvillimet shoqërore kanë bërë që të ndryshojnë edhe raportet në shoqëri dhe në edukim e arsim. Derisa në një kohë fëmijët nuk kishin kurrfarë të drejtash, me kalimin e kohës fëmijët filluan të shikohen si qenie njerëzore me të drejtat dhe obligimet që u takojnë. Me kalimin e kohës, duke i shfrytëzuar njohuritë dhe gjetjet shkencore, u pa se fëmijët janë kategori e ndjeshme, andaj ndaj tyre duhet pasur kujdes. Nxënësit në shkollë, herë pas here, edhe trajtohen në mënyrë jo të drejtë, si nga mësimit dhe stafi i shkollës, ashtu dhe nga shokët e shoqet e klasës. Mësimit janë ata të cilët e kanë përgjegjësinë kryesore për çdo shkelje të të drejtave që u bëhet nxënësve në klasë dhe shkollë. Në asnjë rrethanë nuk duhet lejuar që nxënësit të përqeshen, të rrahën, të fyhen, apo t'u shkelet ndonjë e drejtë e tyre. Të drejtat e nxënësve janë të garantuara me dokumente ndërkombëtare, por respektimi i të drejtave të nxënësve do të thotë edhe respektimi i të ardhmes sonë.

Qëllimi i këtij studimi është që përmes hulumtimi empirik të konstatohet sa respektohen të drejtat e nxënësve në shkollat nëntëvjeçare.

Nga rezultatet empirike u gjet se 86% e nxënësve dhe 89.4% e mësimit konsiderojnë se respektohen mirë të drejtat e nxënësve në shkollë, ndërsa 6.6% e nxënësve dhe 1.2% e mësimit konsiderojnë se nuk respektohen të drejtat e nxënësve. Rezultatet empirike treguan se ka dallime statistikisht të rëndësishme në perceptimin e mësimit dhe nxënësve sa i përket respektimit të drejtave të nxënësve në shkollë, pasi që $Z = -5.431$, dhe $p = 0.000 < 0.05$.

Fjalët çelës: të drejta, nëntëvjeçare, nxënës, respektim, shkollë

1. HYRJE

Të drejtat e fëmijëve në shkollë janë të garantuara me dokumente kombëtare dhe ndërkombëtare.

Po të vështrohet në aspektin historik, fëmija nuk është trajtuar në mënyrë të njëjtë në të gjitha periudhat e zhvillimit njerëzor. Në të kaluarën, fëmijëve të shtresave të varfra u mohojë shkollimi, ndërsa shtresat e pasura, pavarësisht se kishin të drejtë shkollimi, dhuna ndaj nxënësve përdorej si mjet edukativ.

Zhvillimet shoqërore kanë bërë që të ndryshojnë edhe raportet në shoqëri dhe në edukim e arsim. Derisa në një kohë fëmijët nuk kishin kurrfarë të drejtash, me kalimin e kohës fëmijët filluan të shikohen si qenie njerëzore me të drejtat

e tyre. Me zhvillimin e shkencës së pedagogjisë, psikologjisë dhe shkencave të tjera, u gjet se trajtimi i fëmijëve në shkollë ndikon në mirëqenien dhe suksesin e tyre.

Për të drejtat e fëmijëve është filluar vonë të flitet e të shkruhet. Më 1924, Lidhja e Kombeve miratoi një deklaratë, e cila trajtonte problemin e të drejtave të fëmijëve. Edhe pas kësaj janë bërë përpjekje të tjera, ndërsa në vitin 1989 është nënshkruar Konventa për të Drejtat e Fëmijëve. Edhe pse janë shkruar shumë deklarata e janë nënshkruar konventa, prapëseprapë fëmijët nuk i gëzojnë të drejtat që u takojnë. Në shumë vende të varfra fëmijët nuk kanë bazë elementare as për të jetuar, e lëre më të arsimohen. Që të respektohen të drejtat e fëmijëve, duhet të ketë përkujdesje institucionale. Fëmijët duhet të respektohen në familje, në shkollë, në komunitet dhe në cilindo ambient që gjenden.

Shkolla është institucioni ku fëmijëve do të duhej t'u respektoheshin më së shumti të drejtat e tyre, pasi që aty punojnë mësimmësuesit, të cilët kanë përgatitje arsimore, kanë njohuri për zhvillimin e fëmijëve dhe kanë njohuri për pasojat e mosrespektimit të tyre.

Nxënësit e shkollave nëntëvjeçare duhet ta kenë të garantuar shkollimin pa pagesë, trajtimin e drejtë dhe të barabartë, pavarësisht dallimeve që i kanë, të mos ngacmohen, fyhen apo sulmohen fizikisht nga askush. Këto dhe shumë të drejta të nxënësve nuk do të duhej të vareshin nga vullneti dhe dëshira e mësimmësuesve, stafit apo pjesëmarrësve të tjerë, por këto të drejta janë të garantuara me aktet më të larta shtetërore dhe ndërkombëtare.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijës në veçanti sot janë preokupim i shumë vendeve të botës dhe relativisht ato janë fenomene të reja. Thuhet se një prej pengesave kryesore në arsimimin e suksesshëm për të drejtat e njeriut është mungesa e rezultateve nga hulumtimet e detajuara, që kanë të bëjnë me të drejta të grupeve specifike (Akemark, 2003).

Të drejtat e njeriut janë ato të drejta me të cilat kanë lindur të gjithë njerëzit, ato janë universale. Ko do të thotë që të gjithë i gëzojnë këto të drejta, pavarësisht se në cilën pikë të globit banojnë (Mjeldheim, et al. 2005). Për shkak të ndjeshmërisë që kanë fëmijët, përveç Kartës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, ku janë shpallur të drejtat universale nga të cilat mund të përfitojë çdo qytetar, u hartua Konventa specifike për të Drejtat e Fëmijëve. Kjo u bë për shkak se fëmijët kanë të drejtë për një ndihmë dhe përkrahje të veçantë dhe se për këtë fëmija duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen që ka nevojë për lulëzimin harmonik të personalitetit të fëmijës në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi (Muka et al., 2003). Konventa për të Drejtat e Fëmijës fëmijërinë e konsideron si fazë komplekse jetësore, për suksesin e së cilës është i nevojshëm plotësimi i shumë kritereve. Ideja kryesore e konventës është mirëqenia e fëmijës (Salihu, et al. 2006).

Pavarësisht se janë shkruar e nënshkruar shumë dokumente, në botë, ka shumë padrejtësi, për një apo arsye tjetër, shumë fëmijë nuk kanë mundësi të shkollohen, apo edhe në shkollë u shkelen të drejtat e tyre, duke i rrahur, fyer e nënçmuar apo duke i diskriminuar. Për shkak se u shkelen të drejtat e tyre dhe nuk trajtohen me dinjitet, shumë nxënës nuk arrijnë rezultate të mira në shkollë, apo edhe e ndërpresin shkollimin dhe nuk e përfundojnë as shkollimin e obligueshëm.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve i obligon shtetet që çdo fëmije t'i sigurojë arsimim, e cila është e orientuar kah laramania e fëmijëve, talenteve, aftësive mentale dhe fizike deri tek aftësitë e tyre të skajshme. Në bazë të kësaj konvente, fëmijët duhet të përgatiten për jetë të përgjegjshme, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë midis gjinive dhe miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, grupeve kombëtare e fetare dhe personave me origjinë autoktone ([www.unicef.org > sites > files > CRC..](http://www.unicef.org/sites/files/CRC..)). Arsimimi duhet të ofrohet në një mënyrë e cila respekton dinjitetin e lindur të fëmijës, që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës ([www.unicef.org > sites > files > CRC..](http://www.unicef.org/sites/files/CRC..)), që arsimimi duhet të ofrohet në një mënyrë e cila afirmon mënjanimin e dhunës në shkollë.

2.1. Të drejtat e fëmijëve në arsim

E drejta e fëmijëve për arsim është e rregulluar përmes dokumenteve të shumta ndërkombëtare. Në Kosovë, e drejta për arsimim është paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe është përcaktuar si e drejtë e barabartë për të gjithë shtetasit e Republikës dhe Kosova si shtet, garanton mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë individët (Susuri, 2017), sipas mundësive dhe aftësive të veçanta të tyre (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008). Megjithatë, disa grupe në popullsi shpesh përjetojnë forma të ndryshme të përjashtimit social, p.sh. në një studim të kohëve të fundit rreth 16% e prindërve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë u përgjigjën se fëmijët e tyre nuk shkojnë në shkollë. Shumica përmendin varfërinë dhe shëndetin si arsye kryesore që fëmijët e tyre nuk vijnë në shkollë (Save the children, 2015 in Golubeva, 2018), dhe më shumë se 10% e fëmijëve të anketuar romë, ashkalinjë dhe egjiptianë thanë se ishin të diskriminuar në shkollë ose nga bashkëmoshatarët e tyre. Kjo sugjeron që në shumë raste shkollat nuk ofrojnë përfshirje sociale për ata që janë në nevojë. (Golubeva, 2018).

Çdo shkelje e të drejtave të fëmijëve në shkollë, duke përfshirë diskriminimin, dhunën e çfarëdo lloji, përbën shkelje të kushtetutës dhe bie ndesh me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare.

Për të drejtat në arsim, janë mbajtur shumë konferenca, e janë nxjerrë disa dokumente. Më poshtë do të paraqiten disa nga dokumentet që parashihen të drejtat në arsim dhe disa nga konferencat ndërkombëtare, që janë mbajtur me qëllim të realizimit të të drejtave në arsim.

Në Deklaratën Universale (1948), Deklarata për të Drejtat e Fëmijëve (1959), Konferenca Rajonale Botërore për Arsimin e UNESCO-s (1960-1966), Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit Racor (1969), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtën Ekonomike Sociale dhe Kulturore (1976), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrës (1981), Konferenca e Trete Botërore për Gra (1985), Deklarata Botërore për Arsimin për të Gjithë në Jomtien, Tajlandë (1990), Samiti i Arsimimit, E-9 në Nju Delhi (1993), Konferenca Botërore për nevojat Speciale të Arsimimit, Kyçjes dhe Barazisë në Salamankë (1994), Konferenca Ndërkombëtare për Popullim dhe Zhvillim (1994), Korniza e Dakarit për Veprim u miratua në Forumin Botëror të Arsimimit në Senegal (2000) (Benedek&Nikolova, etc, Ed., 2003)

2.2. Roli i shkollës në respektimin e të drejtave të nxënësve

Në kuadër të detyrave të veta, shkolla synon që përmes edukimit për të drejtat e fëmijëve të arrijë të kultivojë raport të tillë ndërmjet faktorëve në mësim në të cilin të drejtat e fëmijëve dhe diversiteti ndërmjet tyre do të kuptohet si pasuri, e cila duhet të mbrojtur e zhvilluar (Salihu, et al. 2006).

Nxënësit duhet të kenë të drejtë të shfaqin lirishit mendimin e tij në të gjitha format: me gojë, me shkrim, publikisht, pa cenuar të drejtat e të tjerëve, të njihet me të drejtat e tij, të marrë pjesë në aktivitete shkollore, edukative, argëtuese, artistike, sportive, etj.

Nxënësi ka të drejtë të bëjë zgjedhje të lirë të orientimit shkollor, të marrë pjesë në mbledhje të ndryshme të klasës e shkollës, të zgjidhet dhe të zgjedhë të tjerët në këshilla, shoqata, organizma të ndryshme, të vlerësohet drejt, të respektohet dhe mos të keqtrajtohet.

Shkolla është institucion që përfaqëson epiqendrën e komunitetit të caktuar shoqëror. Si institucione të veçanta nga pjesa tjetër e shoqërisë, shkollat duhet të kontrollojnë lidhjen e tyre me komunitetin. (Gardner, 2003). Institucionet arsimore duhet të marrin masa konkrete për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve.

Në trajtimin e konceptit “Të Drejtat e nxënësve”, shkolla duhet të fokusohen në çështje të tilla, si:

-Mundësi të barabarta për çdo fëmijë (Fraboni&Minerva, 2003);

-Kërkesa të përshtatshme për periudhat e zhvillimit të fëmijës,

-Vlerësimi i arritjeve dhe të mësuarit efektiv (Tamo et al., 1995).

Shkolla është një faktor shumë i rëndësishëm për edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj. Në kuadër të kësaj, shkolla është institucion, i cili duhet t’i respektojë të drejtat e fëmijëve në edukim dhe arsim. Shkolla duhet të jetë vendi ku personaliteti i nxënësve respektohet pa ndonjë diskriminim të individëve, ose grupeve, bazuar në karakteristika të tilla si: raca, gjinia, formimi kulturor, etnia, religjionin, statusin social-ekonomik apo dallimet e tjera. Shkolla cilësore mund dhe duhet të reduktojë përqindjen e braktisjeve, duke shtuar në të njëjtën kohë njohuritë, duke kaluar nga qasja sasiore në logjikën se si të nxis të mësuarin, duke u nisur nga horizontet dhe interesat e të rinjve, duke përdorur sa më shumë metodën aktive, punën në grup, formimin individual, duke integruar përmbajtjet kurrikulare me edukimin për shëndetin, për ambientin, për parandalimin e sjelljeve devijante (Vergara, 2001), gjithmonë duke i respektuar të drejtat e nxënësve. Shkolla shpesh në kuadër të detyrave dhe obligimeve të saja mundëson kultivimin dhe zhvillimin e një klime të volitshme për realizimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti. (Salihu, et al., 2006). Atmosfera e mirë në shkollë do t’iu ndihmojë nxënësve të kuptojnë të drejtat dhe obligimet e tyre. Demokracia dhe të drejtat e njeriut ndërtohen mbi parimin se çdo person është i rëndësishëm dhe se mendimi i një personi është i vlefshëm si i tjetrit (Graphics & Design).

Të drejta e njeriut nuk do të mbijetojnë aty ku mendimet janë të shtypura. Për këtë duhet krijuar ambient në klasë, ku të gjithë do ndiheshin të sigurt dhe askush nuk është i frikësuar t’i shprehë mendimet dhe opinionet e veta. Të drejtat e nxënësve duhet të prezantohen në situata të përditshme në shkollë. Mësuesit me sjelljet e tyre të mira shërbejnë si model i rëndësishëm për fëmijët. Mësuesit, të cilët vendosin marrëdhënie pozitive me nxënësit, krijojnë në klasë një ambient më të favorshëm për të mësuar dhe plotësuar nevojat zhvillimore, emocionale dhe akademike të tyre. Klima pozitive ndërmjet mësimit dhe nxënësve, e përbërë nga konflikte të pakta, nivele të larta afërsie dhe mbështetjeje dhe varësi e ulët, rezulton me përshtatje më të mirë të nxënësve në shkollë, kontribuon dhe promovon aftësitë e tyre sociale dhe performancën akademike (Kaufman&Sandilos, 2017). Një studim i kohëve të fundit, që ekzaminoi marrëdhënien mësues-nxënës gjatë shkollës fillore, arriti në përfundimin se marrëdhëniet e afërta mësues-nxënës lidheshin drejtpërsëdrejti me arritjet në lexim, ndërsa marrëdhëniet konfliktuale mësues-nxënës lidheshin me arritje të ulëta të leximit (McCormick&O’Connor, 2014).

Marrëdhëniet midis mësuesve dhe nxënësve duhet të bazohen në respektimin e ndërsjellë. Në bazë të nenit 19 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, në veçanti është theksuar që është obligimi i shtetit që të mbrojtë fëmijën nga

çdo formë e dhunës në të gjitha ambientet, përfshirë edhe shkollat ([www.unicef.org](http://www.unicef.org/sites/files/CRC/) > sites > files > CRC..). Dhuna ndaj fëmijës mund të paraqitet në forma më të ndryshme (jo vetëm në formë fizike), si dhe që dhuna, në kuptim të dispozitave të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, konsiderohet edhe dhuna të cilën e ushtrojnë në shkollë fëmijët e tjerë dhe të rriturit.

Nëse të drejtat e fëmijëve nuk respektohen në klasë, nxënësit ngacmohen, fyhen e rrihen, nuk mund të presim që fëmijët të edukohen drejt. Fyerjet në shkollë janë shembull i shkeljes së të drejtave të njeriut (Asllani&Honkala, 2003). Rëndësia e politikave dhe praktikave kundër ngacmimit si një mënyrë për të siguruar respektimin e të gjitha të drejtave të fëmijëve nuk mund të mbivlerësohet. Është shumë e rëndësishme që aktivitetet në këtë fushë të mos kufizohen me ditët ose ngjarjet e informatave të njëhershme, por të përkthehen në politika të përhershme shkollore, të cilat mbahen dhe zbatohen (Golubeva, 2018).

Kur bëhet vlerësimi i nxënësve, mësimdhënësit duhet të kenë kujdes që të jenë korrekt. Shkollat duhet të kenë procedura për ruajtjen e konfidencialitetit të rezultateve të nxënësve (Woolfolk, 2011).

Shkollat janë institucione edukative–arsimore në të cilat punojnë njerëz të përgatitur, që të ushtrojnë profesionin e mësimdhënësit. Andaj në këto institucione në asnjë mënyrë nuk duhet të bëhet shkelja e të drejtave të nxënësve, përkundrazi, shkollat duhet të promovojnë tolerancë, mirëkuptim dhe respektimin e të drejtave të të gjithëve, pa asnjë dallim.

3. METODOLOGJIA DHE METODAT

3.1. Pyetjet e hulumtimit

1. A ka dallime në perceptimin e mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me respektimin e të drejtave të nxënësve nga mësimdhënësit?
2. A ka dallime në perceptimin e mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me respektimin e dallimeve gjinore?
3. A ka ndërlidhje në mes të trajnimeve të kryera për të drejtat e fëmijëve dhe respektimit të të drejtave të nxënësve nga mësimdhënësit?

3.2. Pjesëmarrësit

Në hulumtim janë përfshirë 273 nxënësve dhe 148 mësimdhënësve të shkollave nëntëvjeçare. Në grupin e mësimdhënësve, 72 punojnë nivelin 1-5, ndërsa 76 punojnë në nivelin 6-9, 64 mësimdhënës janë të gjinisë femërore, ndërsa 84 të gjinisë mashkullore, 35 mësimdhënës janë të moshës deri 30 vjet, 43 janë të moshës 31-40, 23 të moshës 41-50, 30 të moshës 51-60 dhe 17 mësimdhënës janë të moshës mbi 60 vjet, 21 prej tyre, kanë kryer nivelin bachelor 3-vjeçar, 96 nivelin bachelor 4-vjeçar, 21 kanë përfunduar master dhe 10 mësimdhënës, kanë përgatitur tjetër arsimore, 36 mësimdhënës kanë përvojë në arsim deri 5 vjet, 41 kanë përvojë 6-15 vjet, 28 kanë përvojë 16-25 vjet, 26 mësimdhënës kanë përvojë 26-35 vjet dhe 17 mësimdhënës kanë përvojë mbi 35 vjet, 74 kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve, ndërsa 74 të tjerë nuk kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve.

3.3. Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit u përdorën dy pyetësorë, njëri pyetësor për nxënës dhe tjetri për mësimdhënës, të përgatitur enkas për këtë studim.

Pyetësorët përbëhet prej 2 pjesëve. Në pjesën e parë janë të dhënat e përgjithshme, të pjesëmarrësve, ndërsa në pjesën së dytë janë 18 pyetje, që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të nxënësve.

3.3.1. Besueshmëria e instrumentit për nxënës

Koeficienti i përgjithshëm Cronbach's Alpha i besueshmërisë së matësit është 0.856, ndërsa sipas modelit parallel koeficienti është 0.854. Koeficienti i besueshmërisë është i lartë dhe tregon se matësi e plotëson kushtin për përdorim.

3.3.2. Besueshmëria e instrumentit për mësimdhënës

Koeficienti i përgjithshëm Cronbach's Alpha i besueshmërisë së matësit është 0.933, ndërsa sipas modelit parallel koeficienti është 0.932. Vlera e koeficientit sipas të dy modeleve është shumë e lartë dhe tregon se matësi është shumë i besueshëm.

3.4. Procedura e mbledhjes së të dhënave

Aplikimi i instrumenteve të hulumtimit u bë gjatë muajit nëntor të vitit 2020. Pyetësorët shpërndanë mësimdhënësve dhe nxënësve, dhe para se të fillonin me plotësimin e pyetësorëve, mësimdhënësit dhe nxënësit u informuan dhe morën udhëzimet e nevojshme se si të plotësohen këto instrumente. Gjithashtu, në instrumentet e hulumtimit kanë qenë të shënuara udhëzimet me shkrim. Pyetësorët u plotësuan në një kohë pas mësimit në prani të studiuesit të problematikës. Nëse gjatë plotësimit të pyetësorëve, pjesëmarrësit kishin nevojë për ndonjë sqarim, studiuesi i problematikës, ia sqaronte secilit.

3.5. Metodat e analizës së të dhënave statistikore

Të dhënat nga hulumtimi sasior janë analizuar përmes paketës statistikore për shkenca sociale (SPSS), ndërsa të dhënat nga hulumtimi cilësor janë paraqitur në formë e shkurtër të qëndrimeve të pjesëmarrësve. Për të testuar

qëndrueshmërinë e brendshme të instrumentit, është përdorur Alpha Cronbach, duke marrë vlerën mbi 0.7 si vlerë që dëshmon nëse pyetësi ka ose jo qëndrueshmëri të brendshme. Për vlerësimin e rezultateve të të gjitha testeve statistikore është vendosur niveli i domethënies statistikore 0.05. Testi Mann Whitney U, është përdorur për të testuar perceptimin e nxënësve dhe mësimdhënësve për respektimin e të drejtave të nxënësve, krahasimin e mësimdhënësve që kanë kryer trajnime dhe atyre që nuk kanë kryer trajnime për respektimin e të drejtave të nxënësve. T-Testi është përdorur për të testuar perceptimin e nxënësve dhe të mësimdhënësve, lidhur me respektimin e dallimeve gjinore të nxënësve.

4. REZULTATET

4.1. Rezultatet përshkruese

Rezultatet e përgjithshme treguan se 89.4 % e mësimdhënësve dhe 86 % e nxënësve konsiderojnë se mësimdhënësit i respektojnë të drejtat e nxënësve në nivel të lartë, 9.4% e mësimdhënësve dhe 7.4 % e nxënësve, konsiderojnë se mësimdhënësit i respektojnë të drejtat e nxënësve në nivel mesatar, 1.2 % e mësimdhënësve dhe 6.6 % e nxënësve, konsiderojnë se mësimdhënësit, të drejtat e nxënësve i respektojnë në nivel të ulët, mesatarja e rezultateve për mësimdhënësit 4.56, ndërsa për nxënësit 4.44.

4.2. Rezultatet lidhur me hipotezat

Hipoteza 1: Mësimdhënësit kanë perceptim më të lartë se nxënësit për respektimin e të drejtave të nxënësve.

Në bazë të rezultateve krahasuese, u gjet se perceptimi i mësimdhënësve është më i lartë, $M=251.46$ se sa i nxënësve që janë subjekti i cili e ka të garantuar këtë të drejtë, $M=189$, $U=14214$, $Z=-5.431$, $p=0.000<0.05$.

Rezultatet treguan dallime statistikisht të rëndësishme në mes të mësimdhënësve dhe nxënësve, në perceptimin e respektimit të të drejtave të nxënësve, ku mësimdhënësit pretendojnë për nivel më të lartë të respektimit të të drejtave të nxënësve. Nga këto rezultate, mund të konstatohet se është mbështetur hipoteza alternative.

Hipoteza 2: Mësimdhënësit kanë perceptim më të lartë lidhur me respektimin e dallimeve gjinore sesa nxënësit.

Sipas rezultateve të analizës, mesatarja e rezultateve për 273 nxënësit pjesëmarrës është $M=3.9$, ndërsa mesatarja për 148 mësimdhënësit pjesëmarrës, $M=4.5$, $F=57.986$, $p=0.000<0.05$. Nga krahasimi i rezultateve, shihet se ka dallime në perceptim nga ana e nxënësve dhe mësimdhënësve, lidhur me pohimin se: mësimdhënësit e respektojnë dallimin gjinor të nxënësve. Mirëpo në bazë të kryqëzimit të rezultateve, vërehet se një pjesë e nxënësve pajtohen me këtë pohim. Nga këto rezultate vërehet se 34 nxënës nuk janë aspak dakord, 23 nxënës dhe 2 mësimdhënës nuk janë dakord, 23 nxënës dhe 20 mësimdhënës deri diku janë dakord, 49 nxënës dhe 28 mësimdhënës janë dakord dhe 144 nxënës dhe 98 mësimdhënës, janë plotësisht dakord me pohimin se: Mësimdhënësit e respektojnë dallimin gjinor të nxënësve. Nëse shikohen mesataret e rezultateve të mësimdhënësve dhe nxënësve, vlerën e F , vlerën e sig 2 tailed, dhe të dhënat e kryqëzimit të rezultateve, vërehet se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikisht në mes të mësimdhënësve dhe nxënësve lidhur me respektimin gjinor të nxënësve nga ana e mësimdhënësve. Rezultatet treguan se është mbështetur hipoteza alternative.

Hipoteza 3: Mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve i respektojnë më shumë të drejtat e nxënësve.

Rezultatet empirike treguan se mesatarja e 74 mësimdhënësve që kanë kryer trajnime për të drejta e fëmijëve është $M=88.38$, ndërsa mesatarja e rezultateve të 74 mësimdhënësve që nuk kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve, $M=60.62$, $U=1711$, $Z=-4.281$, $p=0.000<0.05$. Rezultatet treguan se mësimdhënësit që kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve i respektojnë më shumë të drejtat e nxënësve. Nga këto rezultate u gjet se është refuzuar hipoteza zero dhe është mbështetur hipoteza alternative.

5. DISKUTIMI I REZULTATEVE

5.1. Diskutimi i rezultateve përshkruese

Rezultatet e përgjithshme përshkruese treguan se rreth 89.4% e mësimdhënësve dhe 86 % e nxënësve veprimet e mësimdhënësve i konsiderojnë në nivel të lartë, apo respektimi i të drejtave të nxënësve nga mësimdhënësit është në nivel të lartë. Rreth 9.4 % e mësimdhënësve dhe 7.4 % e nxënësve konsiderojnë se mësimdhënësit i respektojnë të drejtat e nxënësve në nivel mesatar, ndërsa 1.2 % e mësimdhënësve dhe 6.6% e nxënësve konsiderojnë se mësimdhënësit, të drejtat e nxënësve i respektojnë në nivel të ulët, apo nuk i respektojnë fare, mesatarja e rezultateve për mësimdhënës 4.56, ndërsa mesatarja e rezultateve për nxënës 4.44.

Nga këto rezultate, vërejmë një lloj përafrie të perceptimit të mësimdhënësve dhe të nxënësve për respektimin e të drejtave të nxënësve.

5.2. Diskutimi i rezultateve lidhur me hipotezat

Janë bërë shumë testime të variablove, mirëpo në këtë pjesë të punimit do të paraqiten vetëm testimet, të cilat kanë rezultuar të rëndësishme statistikisht.

Kur është në pyetje respektimi i të drejtave të nxënësve nga ana e mësimitdhënësve, çdoherë, pavarësisht se kemi dyshime në këtë respektim, mendojmë se mësimitdhënësit mendojnë se i respektojnë këto të drejta në nivel më të lartë se realisht i respektojnë ose në nivelin që e perceptojnë nxënësit.

Në bazë të rezultateve krahasuese, u gjet se perceptimi i mësimitdhënësve për respektimin e të drejtave të nxënësve është më i lartë sesa i nxënësve. Pra, mësimitdhënësit ndjejnë se i respektojnë më lartë nxënësit, ndërsa nxënësit ndjejnë se po respektohen më pak nga mësimitdhënësit. Mesatarja e rezultateve për mësimitdhënësit është 251.46, ndërsa mesatarja e rezultateve të nxënësve është 189, një dallim statistiki i rëndësishëm për nivelin 0.05.

Respektimi i të dy gjinive nga mësimitdhënësit pa asnjë dallim është kusht dhe e drejtë e secilit nxënës. Nga rezultatet e analizës, u gjet se mësimitdhënësit kanë perceptim më të lartë se nxënësit, lidhur me respektimin gjinor. Mesatarja e rezultateve të mësimitdhënësve është 4.5, ndërsa mesatarja e rezultateve të nxënësve është 3.9. Dallimet në perceptimin e nxënësve dhe të mësimitdhënësve për respektimin gjinor janë statistiki të rëndësishme për nivelin 0.05.

Njohuritë për një çështje ndonjëherë ndikojnë në batimin e duhur ose jo. Trajnimet e mësimitdhënësve për të drejtat e fëmijëve janë të nevojshme e ndonjëherë edhe të domosdoshme, për shkak se mësimitdhënësit marrin njohuri të reja për trajtimin e denjë të nxënësve. Rezultatet empirike treguan se mesatarja e mësimitdhënësve që kanë kryer trajnime për të drejta e fëmijëve është më e lartë se mesatarja e rezultateve të mësimitdhënësve që nuk kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve, sa i përket respektimit të të drejtave të nxënësve. Mesatarja e rezultateve të mësimitdhënësve që kanë kryer trajnime është 88.38, ndërsa mesatarja e rezultateve të mësimitdhënësve që nuk kanë kryer trajnime për të drejtat e fëmijëve është 60.62. Dallimet janë të rëndësishme për nivelin 0.05.

LITERATURA

- Akemar, S. S. (2003). Arsimitimi për të drejtat e njeriut-të arriturat dhe sfidat, IDNJ, Prishtinë.
- Asllani, N., & Honkala, S. (2003). Hapat kosovarë në Edukimin për të Drejtat e Njeriut, QKDNJ, “Dukagjini”, Pejë.
- Benedek, W., & Nikolova, M. (ed.). (2003). Kuptimi i të drejtave të njeriut – Doracak mbi arsimin për të drejtat e njeriut, MPJA dhe “ETC”, Austri
- Delaney, S. (2013). Vlerësimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, World Wision,
- Franco F., & Minerva, F. P. (2003). Manual i pedagogjisë së përgjithshme, ISP, Tiranë
- Gardner, H. (2003). Mendja e pashkolluar, ISP, Tiranë.
- Golubeva, M. (2018). Udhërrëfyes për politikën që mbështesin kulturën demokratike në shkollë, KE, Turkey.
- Kaufman, S., & Sandilos, L. (2017). Improving Students' Relationships with Teachers to Provide Essential Supports for Learning. *Tratto da American Psychological Association:*
<http://www.apa.org/education/k12/relationships.aspx>
- McCormick, M., & O'Connor, E. (2014). Teacher-child relationship quality and academic achievement in elementary school: Does gender matter? *Journal of Educational Psychology.*
- Mjeldheim, L. Et al. (2005). Spektri, “Rozafa”, Prishtinë.
- Muka, P., Hasani, Zh., Dharmo, M., Sinani, M., & Axhemi, S. (2003). Edukimi ndërkulturor dhe i të drejtave të njeriut në shkollë, Tiranë, fq. 59.
- Sadker, M.P., & Sadker, D. M. (1997). Mësuesit, shkolla dhe shoqëria, “Koha”, Prishtinë.
- Salihu, L., Zabeli, N., & Hoti, D. (2006). Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimitdhënësit (tekst universitar për studentët e Fakultetit të Edukimit), KEC, Prishtinë.
- Siniarska-Bychańska, D. (2018). Mbrojtja e së drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Manual për praktikantët e ligjit), KE, Tiranë.
- Susuri, H. (2017). E drejta kushtetuese, Kolegji “FAMA”, Prishtinë.
- Tamo, A. et al. (1995). Pedagogjia (për shkollat e mesme pedagogjike), ISP, Tiranë
- Vergara, F. C. (2001). La promozione del benessere nella famiglia, nella scuola e nei servizi. Milano: Franco Angeli.
- Woolfolk, A. (2011). Psikologji edukimi (botimi i njëmbëdhjetë), CDE, Tiranë, pp 126.
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut. (1998). Tiranë.
- Fjalorth Terminologjik i të drejtave të njeriut. (2002). UNESCO, Tiranë.
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës. UNICEF, www.unicef.org/sites/files/CRC.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës: Për fëmijët, nga fëmijët (2002). Save the Children, Tiranë.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. (2008). Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. (2011). Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë.
- Një studim lidhur me të drejtat e fëmijëve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë. (2015). Save the Children.
- Të drejtat e fëmijës, manual për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës. (2004). KEC, Prishtinë
- Të drejtat e njeriut, Për mësuesit e shkollës fillore, “Graphics & Design”